

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.05.2023*

**11.05.2023
Ora 11:09**

RENDI I DITËS

**Projektvendim “Për shqyrtimin paraprak të kërkesës nr. 56, datë 10.05.2023,
subjekti ankues, Partia Socialiste e Shqipërisë”.**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Ilirjan Rusmali, Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Z. E. Mema,
Znj. I. Osmani, Z. K. Puleri
- **Të tjerë:** s’ka

Z. K. Bele: Çelim seancën publike të KAS, për të verifikuar plotësimin e elementëve të formës dhe përmbajtjes së kërkesës ankimore numër 56, datë 10.05.2023, paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë. Me objekt kundërshtimin e vendimit numër 472 datë 9.05.2023 të KSHZ-së për shqyrtimin administrativ të denoncimit numër 392 nga koalicioni Bashkë Fitojmë për afishimin e materialeve propagandistike në kundërshtim me ligjin nga subjekti zgjedhor PS, në aksin rrugor kombëtar Elbasan-Librazhd për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore datë 14 maj. Relator sipas shortit jam zgjedhur unë, Koli Bele. Të pranishëm KAS në kurum të mjaftueshëm për të dëshmuar këtë seancë. Palë të tjera nuk ka. Sekretari i Përgjithshëm zoti Merkaj, dy fjalë për çfarë jemi sot para KAS-it.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore numër 56 me ankues Partia Socialiste. Objekt i ankimit, kundërshtimi i vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve numër 472, datë 09.05.2023. I cili ka shqyrtuar denoncimin numër 392 të koalicionit Bashkë Fitojmë,

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.05.2023*

pra lëshimin e materialeve propagandistike në kundërshtim me ligjin nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste në aksin rrugor kombëtar Elbasan-Librazhd për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Nga verifikimi i elementëve formal të kërkesës ankimore konstatohet që i plotësojnë këto elementë, sipas nenit 180 të Kodit Zgjedhor. Në këto kushte i kërkojmë KAS-it kalimin e kërkesës për shqyrtim. Faleminderit.

Z. K. Bele: Mirë! Kemi ndonjë pyetje? Pyetje s'ka. Dakord!

KAS i konsultuar në vend vendosi kalimin në seancë për shqyrtimin e themelit duke caktuar si datë, datën e sotme, data 11 ora 15:15 minuta.

Me kaq seanca deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr. 91

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



RENDI I DITËS

Shortit “Për caktimin e relatorëve të kërkesave ankimore nr. 57, 58, 59 dhe kërkesa numër 27 e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për vendosje sanksioni administrativ”.

PJESËMARRJA :

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.**

Z. Y. Merkaj: Atëherë, përshëndetje të gjithëve! Sot, në datën 11.05.2023 ora 11:21 minuta, do të zhvillohet procedura e shortit për caktimin e relatorit, për 3 kërkesa ankimore dhe 1 kërkesë e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për vendosje sanksioni administrativ. Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është depozituar kërkesa ankimore numër 59, 57, 58 dhe kërkesën e Komisionerit numër 27. Për këtë i referohemi nenit 14 të rregullores së KAS-it. Kemi përgatitur 5 shirita letre ku 4 janë vendosur 3 kërkesat ankimore dhe 1 kërkesë e Komisionerit për vendosje sanksioni administrativ. Njëra është e bardhë dhe pa shënime. Palosen shiritat e letrës dhe vendosen në gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë, në një enë transparente. Atëtarët e KAS-it kanë dhënë autorizimin për të tërhequr në emër dhe për llogari të tyre një përfaqësues i KQZ-së filluar nga rendi alfabetik rritës: Elvin Lako, Elvis Çefa, Ilirjan Rusmali, Koli Bele dhe Ledio Braho.

Të pestë goglat janë vendosur në enën transparente, pasi përzihen nga përfaqësuesi i KQZ-së:

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të

- **Zotit Elvin Lako** – Kërkesa e Komisionerit me numër 27.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.05.2023*

- **Zotit Elvis Çefa** – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

- **Zotit Ilirjan Rusmali** - Kërkesa ankimore numër 58.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

- **Zotit Koli Bele** - Kërkesa ankimore numër 57.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

- **Zotit Ledio Braho** - Kërkesa ankimore numër 59.

Në përfundim të procedurës së shortit:

Zoti Elvin Lako – Relator i kërkesës së Komisionerit për vendosje sanksioni administrativ me numrin 27.

Zoti Ilirjan Rusmali - Relator i kërkesës ankimore numër 58.

Zoti Koli Bele – Relator i kërkesës ankimore numër 57.

Zoti Ledio Braho – Relator i kërkesës ankimore numër 59.

Ju faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.05.2023*

11.05.2023
Ora 13:57

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 54, datë 08.05.2023, depozituar nga Partia Socialiste me objekt “Kundërshtim i vendimit nr. 455, datë 06.05.2023. “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 386 nga KRIIK për afishimin e materialeve propagandistike në kundërshtim të ligjit nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” në aksin rrugor kombëtar Tiranë – Lushnjë”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho. .
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema,
Z. K. Puleri.
- **Parti politike:** PS
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. E. Lako: Atëherë, çelim seancën e sotme për shqyrtimin në themel të kërkesës ankimore nr. 54, të depozituar në datën 08.05.2023, nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” me objekt “Kundërshtim i vendimit nr. 455, datë 06.05.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 386 nga KRIIK, për afishimin e materialeve propagandistike në kundërshtim të ligjit nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” në aksin rrugor kombëtar Tiranë–Lushnjë”. Sipas shortit të hedhur relatori i kësaj çështjeje

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.11.05.2023

jam zgjedhur unë, Elvin Lako. Para se të fillojmë me shqyrtimin e çështjes, verifikojmë palët pjesëmarrëse, a janë të pranishme apo jo? Është ankuesi?

Z. M. Legisi: Partia Socialiste e përfaqësuar nga unë, avokat Maringlen Legisi me autorizim të posaçëm të depozituar nga...

Z. E. Lako: Që e keni depozituar mbrëmë pranë administrates. Faleminderit, palë të interesuara nuk ka. Për administratën është Sekretari i Përgjithshëm dhe administrata e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve. A ka ndonjë kërkesë paraprake këtu nga anëtarët e KAS-it, apo nga pala ankimuese për konflikt interesi apo përjashtim anëtarësh, apo...?

Z. M. Legisi: Jo nuk kemi!

Z. E. Lako: Nuk ka. Atëherë meqë nuk ka vazhdojmë me shqyrtimin e themelit të çështjes. Shkurtimisht, Sekretari i Përgjithshëm dy fjalë në lidhje me këtë çështje.

Z. Y. Merkaç: Faleminderit! Po, pranë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve është administruar denoncimi, me denoncues KRIIK-un, i cili pretendon se në aksin rrugor kombëtar nga Tiranë në Lushnjë, përkatësisht në bashkinë Lushnjë, Rogozhinë, Kavajë dhe Durrës janë afishuar materiale propagandistike në kundërshtim me ligjin nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë në shqyrtim administrativ këtë denoncim dhe me vendim numër 455, datë 06.05.2023, ka vendosur urdhërimin e Policisë Bashkiake, dhe Policisë së Shtetit për heqjen e menjëhershme të materialeve propagandistike të subjektit zgjedhor Partia Socialiste, të vendosur në aksin rrugor

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.05.2023*

kombëtar nga Tirana në Lushnjë dhe respektivisht në bashkitë: Tiranë, Durrës, Rrogozhinë, Kavajë dhe Lushnjë, pasi është në kundërshtim me ligjin dhe nuk është vendosur sigla “prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të subjektit zgjedhor” që është Partia Socialiste. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim Partia Socialiste, e cila e kundërshton këtë vendim, pasi pretendohet se është në kundërshtim me ligjin dhe nga ana e Partisë Socialiste, brenda afatit ose pas, kur është marrë vendimi nga data 6 maj e mbrapa është vendosur shënimi: “prodhuar nën përgjegjësinë të logos” dhe ka sjellë dhe fotot ilustruese që tregojnë që është vendosur ky shënim. Ju faleminderit!

Z. E. Lako: Domethënë me sa kuptova, ankimi është bërë vetëm se nuk ka atë shënimin...

Z. Y. Merkaj: “Prodhuar nën përgjegjësinë e subjektit zgjedhor ...”

Z. E. Lako: Edhe një pyetje kot, se kam parë nja dy ankime të tjera del aksi Tiranë–Rrogozhinë, tani del Tiranë –Lushnjë. Kjo është duke u shtuar në ankim duke u shtuar aksi apo ...?

Z. Y. Merkaj: Jo! Është vendosur reklama edhe në Elbasan–Librazhd.

Z. E. Lako: Faleminderit. Për palën ankuese?

Z. M. Legisi: Po, faleminderit i nderuar! Të nderuar anëtarë të Komisionit, të shoqatës, përtej relatimit të bërë nga ana e KQZ-së. Në vlerësimin tonë ka pasur një mospërputhje, ose më saktë ka pasur një vlerësim të gabuar të fakteve, pasi vendimi i Komisionerit sikurse ka rezultuar, e provuar nga provat e depozituara në këtë ankim

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.05.2023*

pranë KAS-it, të gjitha posterat e kanë pasur shënimin që ankuesi ka pretenduar që mungon. Po ashtu edhe nga ana e KSHZ-së në vendimin “Objekt ankimi” është konstatuar, por faktikisht nuk është i qartë, sepse ne provat i kemi mjaft të qarta, dhe tregon që ky, të gjitha posterat e kanë mbajtur shënimin. Ne, në rasti konkret, kërkojmë që KAS-i të marrë si provë, dhe marrja e provës ne kuptojmë që të bëhet një konfirmim apo konstatim në terren për të verifikuar nëse këto e kanë apo jo shënimin. Provat që ne i kemi depozituar janë të tilla, që mbështesin pretendimin tonë. Ky është vlerësimi në themel i çështjes nga ana jonë. Kemi edhe një çështje formale, le të themi në bazën ligjore të vendimit, KQZ-ja është bazuar në nenin 79, pika 2 të Kodit Zgjedhor, ku faktikisht, kjo referencë ligjore bën pjesë në lidhje me distancat dhe duket sikur shkelja është në lidhje me mosrespektimin e distancave. Nuk e di se sa mund t’i shërbej këtij Komisioni në lidhje me pretendimin tonë, gjithsesi, ne e kemi parashtruar si të tillë. Në themel, ne kërkojmë që të merren provat, duke konstatuar adresë për adresë në lidhje me posterat, dhe në përfundim të vijohet me pranimin e ankimit. Faleminderit!

Z. E. Lako: Faleminderit! Pra, edhe një herë zoti Merkaj, juve... KQZ-ja, ka bërë një verifikim, që ju thatë: “që është plotësuar tani kjo kërkesë”. Keni bërë ndonjë verifikim para se të merrej vendim para nga Komisioneri dhe pas, apo e konstatoi edhe ju nga fotot e dorëzuara nga subjekti. Keni bërë ndonjë verifikim në vend, në bazë të denoncimit që është bërë?

Z. Y. Merkaj: Po, pasi është marrë vendimi nr. 455, që është urdhëruar Partia Socialiste t’i heqi dhe Policia Bashkiake t’i heqi, është bërë dhe një verifikim nga monitoruesit e informuar nga KQZ-ja, ku monitoruesit kanë shkuar në çdo tabelë, kanë parë, kanë bërë fotot dhe na i kanë sjellë dhe ...

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.05.2023*

Z. E Lako: Janë vendosur.

Z. Y. Merkaj: Eshte vërtetuar që janë vendosur.

Z. E. Lako: Pra ankimi ka të bëjë thjesht me, jo vetëm me gjë tjetër, për shembull se u diskutua jo largësitë, por vetëm me vendosjen e kësaj fjalisë. Dhe sot janë vendosur.

Z. Y. Merkaj: Ankimi unë nuk e e di pse është bërë, por vendimi është marrë vetëm në kundërshti me pikën 3 të nenit 79.

Z. E. Lako: Mirë, faleminderit! Ka ndonjë pyetje nga kolegët?

Z. I. Rusmali: Domethënë ju i keni konstatuar më pas, si ka dalë vendimi, që shkelja, në fakt nuk ekziston.

Z. Y. Merkaj: Në momentin që është marrë vendimi i Komisionerit, shkelja ka qenë..

Z. I. Rusmali: Dakord, por pas, keni konstatuar që shkelja...

Z. Y. Merkaj: Pasi ka shkuar Policia Bashkiake dhe Shtetit...

Z. I. Rusmali: Dakord! Po pse nuk keni bërë anulimin e vendimit, kur keni krijuar këtë bindje?

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.11.05.2023

Z. Y. Merkaj: Po vendimi është që ku, nuk e ka logon të hiqet, kush nuk e ka këtë shënimin kështu që e kemi konsideruar të zbatuar, të ezauruar, si vendim.

Z. I. Rusmali: Dakord. Do të thotë që këta s'kanë motiv ta kundërshtojnë vendimin, sepse janë në rregull me vendimin?

Z. Y. Merkaj: Do të thotë që, në ato reklama ku nuk është shënuar kjo, do të hiqet. Vendimi ka dhënë pasojat, por edhe subjekti zgjedhor ka reaguuar, dhe ka ndryshuar, ka vendosur logon ose shënimin

Z. I. Rusmali: Dakord. Ça thotë ankuesi për këtë ?

Z. M. Legisi: Shënimet, Partia Socialiste mban qëndrimin, shënimet kanë qënë që në momentin kur janë vënë posterat, pra posterat kanë pasur shënime.

Z. I. Rusmali: Zoti Merkaj po thotë që, në rastet kur janë shënimet vendimi nuk i prek, të gjitha postimet që janë me shënime, nuk i prek, nuk i cenon ato. Dëmethënë edhe juve nuk ju cënohet asgjë nga kjo, nga ky veprim i këtij.

Z. E. Lako: Të bëjmë një sqarim në bazë të vendimit, nuk janë përcaktuar në këtë formë, thotë: “urdhërimin e subjektit që të heqi menjëhere të gjitha materialet e vendosura në aksin rrugor” pa bërë ndonje sqarim kush eshte me, apo pa, kështu që kanë të drejtë ata që kanë bërë ankim, sepse nuk është i përcaktuar në vendim, në dispozitiv që kush janë me, dhe kush janë pa.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.05.2023*

Z. I. Rusmali: Eventualisht, kam edhe unë të drejtë të them pse nuk e anulojnë kur kanë konstatuar që është.

Z. E. Lako: Kështu i bie...

Z. Y. Merkaj: Në arsyetimin e vendimit pavarësisht që nuk është në dispozitiv.

Z. E. Lako: Po zoti Braho.

Z. L. Braho: Atëherë me sa kuptova unë zotin Merkaj, në momentin që është marrë vendimi asnjë prej tabelave nuk e kanë pasur shënimin për përgjegjësinë ligjore të Partisë Socialiste, dhe kur kanë shkuar Policia Bashkiake dhe Policia e Shtetit për të ekzekutuar vendimin e Komisionerit, e kanë pasur të gjitha shënimin. Po kemi foto ne, të para dhe të pas, që i ka sjellë vetë përfaqësuesi, ankuesi. Për pjesën para, kemi foto?

Z. Y. Merkaj: Po kemi foto, që është pa shënim dhe foto që janë me shënim.

Z. L. Braho: Kam edhe një pyetje për përfaqësuesin e Partisë Socialiste. Nëqoftëse këto tabelat e kanë të gjitha shënimin sot, pavarësisht e kanë pasur më përpara apo jo. Sot e kanë të gjitha dhe nuk janë ekzekutuar nga Policia Bashkiake, çfarë interesi të ligjshëm keni ju për ta bërë këtë ankim?

Z. M. Legisi: Po, faleminderit. Kjo situatë faktike e lë, e bën ankimin pa objekt, por gjithsesi, jemi në një situatë kur edhe vendimi i Komisionerit është i tillë, që në një

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.05.2023*

ekzekutim nga ana e organeve policore mund të sjellë problematika. Prandaj, edhe ne kërkojmë që të na pranohet ankimi.

Z. K. Bele: Më fal, mund të them diçka, se mora dhe këtë provën, pra mesa kuptoj unë drejt, kjo ka qënë nga ato provat mbi të cilat është mbeshtetur vendimi, për arsye që, në kuptueshmërinë time lidhen me gërmat e vogla. Kjo fotografi, të cilën ju keni konstatuar se s'ka shënim. Këtu janë depozituar disa fotografi që duket shënimi, më korrigjoni nëse unë e kam kuptuar keq, por mua më duket, sikur për shkak të mënyrës si janë bërë fotografitë, edhe në rastin kur ka qënë ky shënimi mikroskopik apo i vogël, si të duash mund ta quajmë, nuk është konstatuar drejt. A është kjo situata? Ose, a e përjashtoni që mund të ketë ndodhur kështu juve?

Z. Y. Merkaç: E përjashtojmë, sepse kemi pasur raportet e monitoruesve që thonë që: 'nuk ka qënë shënimi'.

Z. K. Bele: Kjo është nga ato raportet e monitoruesve?

Z. K. Puleri: Eshtë fotoja, por duke qënë bardhë e zi nuk duket. Në sistem, neve, nëqoftëse e zmadhojmë atë foton duket qartësisht ajo, që nuk ka qënë shënimi.

Z. K. Bele: Pra ky nuk është shënimi?

Z. K. Puleri: Jo, jo! Aty është shtuar shënimi. Po të shohim në fotot pasardhëse..

Z. K. Bele: Pra ju i rrini qëndrimin që ato foto mbi të cilat ju i keni vlerësuar, nuk duket shënimi. Nuk ka. Dakord, po këtu, ka ndonjë rregullim për këtë qëllim, për

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.05.2023*

madhësinë e gërmave, raporti që duhet të ketë shënimi në këto slloganet që shkruajnë me gërma të mëdha.

Z. Y. Merkaj: Jo, nuk ka. Si rregull, duhet të jetë i dukshëm.

Z. K. Bele: Si logjikë, se rregulli është ai që është shkruajtur.

Z. Y. Merkaj: Si logjikë, kur ta shikojë tjetri nga larg ta evidentojë që është... Por nuk ka rregull të shkruar.

Z. K. Bele: Lidhur me përgjegjësinë ligjore apo ka të bëjë me informimin e publikut?

Z. Y. Merkaj: Edhe me informimin e publikut.

Z. K. Bele: Nga e konkludojmë këtë? Se kam parasysh për analogji ato gjërat e vogla që shkruhen nëpër kontrata apo nëpër produkte, që janë zakonisht për të të orientuar për një çështje të caktuar ligjore, të paktën kështu e kuptoj unë.

Z. Y. Merkaj: Ato bëhen për efekt të vendit në fletën që shkruajnë.

Z. K. Bele: Kjo është çështje interpretimi, mbase duhet mbajtur shënim për ndonjë akt nënligjor për zgjedhjet e tjera që të kuptohet. Po madhësia, qëllimi, është për arsye identifikimi të përgjegjësise ligjore, nëse kjo ka sjellje, ku di unë, thirrje raciste, ose krijon një proces gjyqësor?! apo është për t'i thënë publikut që kjo reklama që shkruan Partia Socialiste është nën përgjegjësinë ligjore të Partisë Socialiste?! Se unë mendoj se është për t'u parë, se kjo është reklamë politike e çdo

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.11.05.2023

partie, dhe nuk i vlen publikut shënimi i përgjegjësise ligjore, megjithatë ky është mendimi im. Mund të jem i gabuar.

Z. E. Lako: Ka pasur ndonjë pretendim nga dikush për këto postera, ose këto që nuk janë të këtij subjekti?

Z. Y. Merkaj: Nuk ka pasur, por ne, KQZ-ja, duke qenë se merret edhe me financimin e fushatës të subjekteve zgjedhore, në fund, kur do të vijnë raportet e monitoruesve, të audituesve do të shënohet që kjo është bërë, është prodhuar, dhe futet tek shpenzimet e fushatës së subjekteve zgjedhore.

Z. E. Lako: E qartë. Sot janë të vëna këto shënime. Ndonjë pyetje tjetër ka?

Z. E. Çefa: Faleminderit, unë kam një të fundit për administratën e KQZ-së, tashmë që është konstatuar fakti që ankimuesi e ka riparuar rekomandimin e lënë me vendimin “Objekt ankimi” të Komisionerit dhe nuk ka më shkaqe ligjore që Policia Bashkiake, apo qoftë Policia e Shtetit të shkojë më dhe të heqë posterat në fjalë. A e garantoni ankimuesin, që ju do ta njoftoni policinë për faktin që ajo e ka riparuar shkeljen ligjore?

Z. Y. Merkaj: Kemi pasur komunikim me Policine Bashkiake dhe të Shtetit ne i kemi informuar dhe udhëzuar që ku është shënimi: “prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të subjektit zgjedhor” nuk do të hiqet.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.11.05.2023

Z. E. Çefa: Dakord, pra praktikisht, subjekti ankimues nuk rrezikon që t'i hiqen aktualisht këto postera gjithmonë me justifikimin se po zbatoj vendimin e Komisionerit.

Z. Y. Merkaç: Policia Bashkiake dhe policia e Shtetit është e detyruar të raportojë në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve për çfarë ka bërë me të gjitha këto akse, me urdhërimet e Komisionerit.

Z. E. Çefa: Dëmthënë ankimuesi, besoj unë, që praktikisht, ankimi është pa objekt tashmë, vendimi "Objekt ankimi" e ka krye efektin e vet, ju e keni riparuar defektin, pra, e keni pranuar ankimin, e keni riparuar difektin dhe në këto kushte, ju nuk rrezikoni më t'u hiqen ato posterat, kështu që, ne kot që, besoj unë që ky nuk ka më objekt ky ankim. Mendoj unë...

Z. L. Braho: Mund ta kemi këtë shkresën që ju jeni drejtuar policive?

Z. Y. Merkaç: Po, mund t'ua vë në dispozicion. Janë dy shkresa.

Z. E. Lako: Mirë me duket që nuk ka më pyetje.

Z. I. Rusmali: Çështja është që si do konkludojmë? Cfarë sensi ka?

Z. E. Çefa: Të heqin dorë nga ankimi.

Z. I. Rusmali: Po ta dëgjojmë një herë.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.05.2023*

Z. E. Lako: Po, do dëgjojmë pretendimet e fundit, si të administratës dhe ankuesit.

Z. I. Rusmali: Po ta bëjmë njëherë si pyetje. Pala ankuese, në këto rrethana faktike, e shihni si opion ju, heqjen dorë nga ankimi?

Z. M. Legisi: Po! Faleminderit! Unë si përfaqësues kam një autorizim të posaçëm dhe e kam pak të kufizuar në tagër sidomos në lidhje me heqjen dorë nga ankimi i nderuar kështu që, në vlerësimin tim unë i qëndroj ankimit. Faleminderit.

Z. E. Lako: Ka më pyetje?

Z. I. Rusmali: Edhe një të fundit. Ju e shihni si opion ta shfuqizoni vendimin. Shfuqizimi sjell pasoja nga momenti i shfuqizimit e mbrapa. E shihni si opion që ta kursejmë këtë.

Z. Y. Merkaj: Ideja është se nuk ka sens. Ne kemi që në datën 6 që është bërë vendimi, ato nuk kanë pasur logo. Nuk e kanë pasur.

Z. I. Rusmali: Jo, jo, nuk po them ta anuloni, po them ta shfuqizoni.

Z. Y. Merkaj: Po si?

Z. I. Rusmali: Sot nisur nga fakti që të gjitha tabelat kanë sqarimin ligjor, mbështetur në këtë fakt, është normale që urdhërimi të ndërpritet. S'ka nevojë më. Ky vendim shfuqizohet. Është korrekte kjo? Pse duhet të futeni në procedura ankimore për një gjë që nuk bën asnjë sens. Çfarë do kërkohet nga ne? Do kërkohet që ne të rrëzojmë

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.05.2023*

vendimin? Është i kundraligjshëm vendimi? Si thoni? Po, mirë, neve do rrëzojmë ankesën, do mbajmë në fuqi vendimin. Ka efekte juridike vendimi?

Z. Y. Merkaj: Atëherë më jepni pak kohë të konsultohemi me Komisionerin.

Z. I. Rusmali: Po pse duhet? E kursejmë këtë procedurë. E kursejmë fare këtë procedurë. Nuk ka asnjë sens të investohet kjo procedurë.

Z. E. Lako: Ka më pyetje, të kalojmë të pretendimet?

Z. Y. Merkaj: Ose më jepini pak kohë sa t'i printojmë nga...

Z. E Lako: E nderpresim seancën, sapo të na sillni këto provat e fundit dhe e rifillojmë për, diku për 10 minuta.

Rifillon seanca

Ora 14:35

Z. E. Lako: Mirë, atëhere vazhdojmë seancën aty ku e lamë. U njohëm me këto kopjet e fotove që na solli administrata e KQZ-së. Nga anëtarët e KAS-it ka më ndonjë pyetje? Nuk ka! Atëhere shkurtimisht çfarë kërkonit me ankuesin nga KAS?

Z. M. Legisi: Po, faleminderit i nderuar. Nga KAS-i, ne kërkojmë pranimin e kërkesës ankimore nr. 54 të datës 08.05.2023, në bazë të nenit 45, pika 1, gërma "c", të vendosë shfuqizimin e vendimit. Faleminderit!

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.05.2023*

Z. E Lako: Faleminderit, nga ana e Sekretarit të Pergjithshëm?

Z. Y. Merkaj: Rrëzimin e kërkesës ankimore nr.54, lënien në fuqi të vendimit numër 455 të datës 06.05.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Faleminderit!

Z. E Lako: Domethënë, ju kerkoni rrëzimin e ankesës, sepse e ke shfuqëzuar ti vendimin?

Z. Y. Merkaj: Po!

Z. E Lako: Do të tërhiqemi për vendim, besoj për 10 minuta, do ju thërrasim prapë, faleminderit.

Rifillon seanca

Ora 14:57

Z. E. Lako: Atëherë riçelim seancën për shpalljen e vendimit për kërkesën ankimore nr. 54, të Komisionerit, në mbështetje të nenit 143, pika 1, shkronja “c” të ligjit nr.10,019 datë 29.12.2008, të Kodit Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve vendosi:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës ankimore të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, ndryshimin e pikës 1 të vendimit nr. 455, të datës 06.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 386 nga KRIK për afishimin e materialeve propagandistike në kundërshtim të ligjit nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, në aksin rrugor kombëtar Tiranë- Lushnjë”, duke e riformuluar si më poshtë:

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.05.2023*

Urdhërimin e Policisë Bashkiake dhe Policisë së Shtetit për heqjen e menjëherëshme të materialeve propagandistike të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” të vendosura në aksin rrugor kombëtar nga Tirana në Lushnjë, respektivisht në bashkitë Tiranë, Durrës, Rrogozhinë, Kavajë dhe Lushnjë, të cilat nuk përmbajnë shënimin “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të Partisë Socialiste të Shqipërisë”.

- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Administrativ brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Me kaq e deklaroj të mbyllur seancën.

Vendimi nr. 92

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.05.2023*

11.05.2023

Ora 14.59

RENDI I DITËS

**“Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 55, datë 08.05.2023, depozituar nga koalicioni
“Bashkë Fitojmë”.**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, znj. I. Osmanaj, z. E. Mema, z. K. Puleni.
- **Parti politike:** “Bashkë Fitojmë”.
- **Të tjerë:** KRIIK, OSBE /ODIHR.

Z. K. Bele: E deklaroj të çelur seancën publike për shqyrtimin në themel të kërkesës ankimore numër 55, depozituar më datën 8.05.2023, nga koalicioni “Bashkë Fitojmë”, me objekt kundërshtimin e vendimit të KSHZ numër 452, datë 06.05.2023 “Për vlerësimin e raporteve të monitoruesve të fushatës zgjedhore për periudhën e monitorimit 7 mars deri më 2 maj 2023”; pika 2: kundërshtimin e vendimit të KSHZ, numër 456, datë 06.05.2023 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit numër 3/187 PS e Shqipërisë “ Për heqjen e materialeve zgjedhore të vendosura në kundërshtim me ligjin nga koalicioni “Bashkë Fitojmë””; ndryshimi pjesërisht në vendimin e KSHZ, numër 452, datë 06.05.2023, duke vendosur pushimin e hetimit administrativ në lidhje me kërkesat për mbylljen e zyrave zgjedhore të subjektit koalicioni “Bashkë Fitojmë” në bashkinë Tiranë me vendndodhje rruga “Artan

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.05.2023*

Lenja”, rruga “Milto Tutulani”, rruga “Margarita Tutulani”; në Bashkinë e Elbasanit me vendndodhje pranë universitetit “Aleksandër Xhuvani”; pika 3/b pushimin e hetimit administrativ në lidhje me kërkesën për mbylljen e zyrës së Partisë Demokratike në rrugën “Nasi Pavllo”, pranë liceut artistik për arsye se kjo zyrë nuk i takon subjektit zgjedhor PD, të regjistruar në këto zgjedhje nga KQZ, por i takon entitetit politik që të identifikohet me koalicionin “Bashkë Fitojmë” dhe për më tepër kjo nuk është zyrë elektorale në kuptim të Kodit Zgjedhor, por zyrë e përhershme politike selia dega numër 2 e PD-së Tiranë; pika c, pushimin e hetimit administrativ në lidhje me kërkesën për heqjen e materialeve propagandistike në Bashkitë Durrës Tiranë, në lidhje me subjektin koalicioni “Bashkë Fitojmë” në shtylla ndriçimi në rrugën “Veli Dedi”; ndryshimin e vendimit të KSHZ-së numër 456 datë 06.05.2023, duke vendosur pushimin e hetimit administrativ në lidhje me heqjen e menjëhershme të materialit propagandistik mbi fasadën e godinës Posta Shqiptare në Kavajë, subjekti koalicioni “Bashkë Fitojmë”. Sipas shortit të kësaj çështjeje relator jam unë Koli Bele. Verifikojmë prezencën e palëve. Prezent është KAS-i, si edhe administrata e KQZ –së. Palët e tjera prezentë, ju lutem, identifikohuni!

Z. F. Nuri: Franci Nuri, përfaqësues i koalicionit “Bashkë Fitojmë”.

Z. K. Bele: Po, Faleminderit!

Në këtë fazë kemi kërkesa paraprake, deklarime?

Z. F. Nuri: Jo, nuk kemi.

Z. K. Bele: Atëherë, dëgjojmë palën ankuese për një paraqitje të shkurtër të kërkesave të veta.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjitha LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.05.2023*

Z. F. Nuri: Atëherë, pa dashur t'ju marr më tepër kohë, meqenëse e nisëm dhe me pak vonesë, shkurtimisht do t'ju them se në seancën e datës 6 maj Komisioneri Shtetëror mori dy vendime objekt ankimi, për të cilat, ne, si subjekt zgjedhor, koalicioni “Bashkë Fitojmë”, nuk jemi dakord. Interesi ynë i ligjshëm cenohet nga këto dy vendime për sa kohë me anët të tyre është vendosur mbyllja e disa zyrave elektorale kryesisht në Tiranë, një në Elbasan, dhe janë marrë disa vendime të tjera për heqjen e materialeve propagandistike në qytet e ndryshme, përfshi dhe qytetin e Kavajës. Vendimet objekt ankimi ne na rezultojnë se janë marrë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ditën e shtunë, pra dhe ankimimi është bërë brenda afateve sipas afateve të përcaktuara nga Kodi Zgjedhor, neni 125 i tij. Për sa kohë ne arrijmë të provojmë se jemi subjekt zgjedhor i regjistruar dhe për sa kohë kemi paraqitur ankim në KAS, brenda afateve, për të kundërshtuar këto vendime ne çmujmë se plotësojmë kërkesat për t'u legjitimuar në të drejtën tonë për t'u dëgjuar nga KAS-i. Në lidhje me faktet dhe argumentet ne kemi ngritur pretendimin që mund të ketë dhe gabime materiale në vendimin e Komisionerit, sepse dua ta theksoj më tepër ka të bëjë ankimi me pjesën e asaj, që ka ndodhur, me vendimmarrjen që ka ndodhur në degën e njësisë numër 2 të subjektit Partia Demokratike, e cila është vendosur të Liceu Artistik, por me kryetar zotin Berisha. Ne nuk duam ta paragjykojmë vendimmarrjen e KQZ-së në rastin konkret, mendojmë se ka qenë gabim njerëzor material dhe ajo degë nuk është degë elektorale nga këto zyrat elektorale të përkohshme që hapen raste fushatash, por është një degë e mirëfilltë politike, ku zhvillohet aktivitet politik i subjektit Partia Demokratike, që në këto zgjedhje do ta identifikojë veten e saj me koalicionin “Bashkë Fitojmë”.

Ne paraqitëm dhe në seancën e kaluar, dhe provat foto, dhe kopjen e kontratës së qirasë për ambientin e këtij lokali, ku vërtetohet te neni 4 i kontratës që ajo shërben

Zbardhi materialin audio

Mirgjinja LEKAJ



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.05.2023*

si zyrë elektorale e njësisë numër 2 në Tiranë, të Partisë Demokratike, sikundër jua shpjeguam. Pa dashur të zgjatem ne kërkojmë që të pranohet ankimi ynë, bazuar mbi ato që relatova më lart. Faleminderit!

Z. K. Bele: Lidhur me sa u parashtrua?

Z. Y. Merkaç: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka emëruar 120 monitorues për fushatën zgjedhore të datës 14 maj të vitit 2023, ku monitoruesit kanë detyrë të raportojnë për monitorimin e fushatës zgjedhore në të gjithë Republikën e Shqipërisë. Për periudhën 23 janar - 2 maj 2023 janë përcjellë rreth 997 raporte monitorimi në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Nga vlerësimi këtyre raporteve për periudhën 7 mars-2 maj ka rezultuar se 16 prej këtyre raporteve pasqyrojnë shkelje të Kodit Zgjedhor dhe të udhëzimit numër 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për përdorim të materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore. Duke qenë se nuk është respektuar udhëzimi numër 6, te neni 79 i Kodit Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka konstatuar ndër të tjera për subjektin zgjedhor Partia Socialiste për koalicionin Bashkë Fitojmë tri shkelje: për bashkinë në adresën e rrugës “Artan Lenja” është një zyrë zgjedhore, e cila është 150 metra larg shkollës “Gustav Majer”; për bashkinë Tiranë rruga “Milto Tutulani”, zyra zgjedhore është 58 metra larg qendrës së votimit, gjithashtu në Bashkinë e Tiranës në adresën rruga “Margarita Tutulani” është zyra zgjedhore 110 metra larg qendrës së votimit. Gjithashtu, për subjektin zgjedhor Partia Demokratike duke qenë se është 180 metra larg qendrës së votimit të shkollës “Jordan Misja” është një zyrë zgjedhore. Po të gjitha këto janë objekt i ankimit. Ka vendosur urdhërimin e Policisë Bashkiake dhe Policisë së Shtetit për mbylljen e menjëhershme të zyrave zgjedhore në Bashkinë Durrës,

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.05.2023*


Kavajë, Kukës, Tiranë. Gjithashtu, me vendimin numër 456 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë në shqyrtim denoncimet e Partisë Socialiste për vendosjen e një posterit të madh të kandidatit të koalicionit “Bashkë Fitojmë” mbi fasadën e godinës Posta Shqiptare, duke qenë se e ka gjetur në kundërshtim me nenin 3 pika 2 të udhëzimit numër 6 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ka vendosur urdhërimin e Policisë Bashkiake të Kavajës dhe Policisë së Shtetit për heqjen e menjëhershme të materialit propagandistik mbi fasadën e godinës së Postës Shqiptare të Kavajës të subjektit zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim subjekti koalicioni “Bashkë Fitojmë”. Mendojmë se kërkesa ankimore është e paarsyetuar nuk ka asnjë justifikim.

Z. K. Bele: Faleminderit! Para se të shkojmë te kërkesat e zotit Nuri, meqë është si episod më vete, kjo e rastit të Postës së Kavajës, çfarë argumenti keni për ligjshmërinë e saj?

Z. F. Nuri: Nuk është se i kemi ndarë elementet në detaje. Të themi të drejtën ne gjykojmë që KQZ-ja ka gabuar në fakt. Pra, nuk përputheshin me realitetin. Ky është mendimi ynë.

Z. K. Bele: Jam dakord te argumenti që ju bëtë. Do të flasim më vonë në seancë paraprake për zyrën e PD-së po për episodin se ne detyrohemi që në fakt t’i marrim rast pas rasti kur mundemi dhe besoj se ky është i dallueshëm nga ato të zyrave. Bëhet fjalë për një poster në një godinë publike, në një fasadë. Bëhet fjalë për Postën Shqiptare e cila është sh.a, me kapital shtetëror. A mendoni se mund të qëndrojë posteritë te godina e postës, OSHE-së apo OST-së që po më vijnë ndërmend si të ngjashme?

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.05.2023*

Z. F. Nuri: Nuk e njoh qytetin e Kavajës dhe nuk e kam parasysh si është pozicionuar apo si është vendosur në rastin konkret kështu që nuk mund të shprehem konkretisht për si qëndron realiteti, por po marrim të mirëqena konstatimet që janë bërë.

Z. Y. Merkaj : Posta e Kavajës është në qendër të qytetit dhe posterit që është vendosur në të gjithë fasadën është mbi 100 metër katror.

Z. L. Braho: Kam një pyetje për zotin Merkaj. Tani po të lexojmë udhëzimin numër 6, neni 3, pika 2, normalisht që Komisioneri të dalë me udhëzim duhet të ketë një autorizim nga Kodi Zgjedhor. Ku parashikohet në Kodin Zgjedhor ndalimi i afishimeve në fasadat e godinave të banimit, të institucioneve publike, e të tjera? Pse për Komisionerin Posta Shqiptare është institucion publik?

Z. Y. Merkaj: Atëherë, nenin 79, pika 2 thotë që gjatë fushatës zgjedhore përdorimi i afishimit të çdo materiali zgjedhor statik për propagandë zgjedhore, përfshirë flamujt dhe posterët, lejohet vetëm në një largësi prej 5 metra nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës.

Z. L. Braho: Çfarë lidhjeje ka me institucionet publike kjo? Se në dijeninë time vetëm ky nen është për materialet propagandistike në Kod Zgjedhor, ndërkohë që udhëzimi është jo shterues. Zoti Nuri, ky posterit a e ka pasur shënimin e përgjegjësisë?

*Zbardhi materialin audio
Mirgjyha LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.05.2023*

Z. F. Nuri: Nuk jam në dijeni të këtij fakti, por për të bërë një shtesë nga pyetja që ju ngritët pak më parë për Komisionerin është e vërtetë ajo që duhet të arrijmë të kuptojmë që, së pari, është një institucion shtetëror dhe Posta Shqiptare mund të konsiderohet edhe me formë juridike sh.a dhe duhet ta provojë KQZ-ja që është e varur apo e lidhur në një farë mënyre me shtetin. Megjithatë shikoj që barra e provës i takon administratës për të treguar ligjshmërinë e veprimeve dhe vendimmarrjeve të saj.

Z. Y. Merkaj: Ky poster nuk është vendosur në vendin e miratuar nga kryetari i bashkisë për materialet propagandistike.

Z. I. Rusmali: A mund të ma thoni ju të administratës çfarë thotë pika 2, e nenit 3 të udhëzimit numër 6 të Komisionerit?

Z. Y. Merkaj: Atëherë, pika 2 e neni 3 thotë që ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambienteve rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, të pemëve të qytetit dhe shtyllat e ndriçimit.

Z. L. Braho: Prapë, zoti Merkaj, në vendimmarrje ka arsytim tjetër, sepse thuhet pas verifikimit të të dhënave provave fakteve, si edhe raportit të monitorimit, vlerësoj se materialet propagandistike, këtu kalon në shumës, ndërkohë që objekti është vetëm për një material propagandistik, janë vendosur në kundërshtim të nenit 3 pika 2 të udhëzimit. Pra, për Komisionerin shkelja ka qenë vetëm pjesa që ai e ka konsideruar institucion publik, jo, nëse është vendosur, ose jo në vendet e caktuara

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.05.2023*

nga bashkia. Kurse tjetra është: a është ekzekutuar ky vendim i Komisionerit nga Policia Bashkiake apo jo?

Z. Y. Merkaj: Jo, edhe pas kërkesës së subjektit zgjedhor nuk është hequr, edhe Policia Bashkiake nuk e ka ekzekutuar. KQZ-ja i është drejtuar subjektit ta heqë, subjekti nuk e ka hequr.

Z. I. Rusmali: Ju, Postës Shqiptare a i keni kërkuar informacion?

Z. Y. Merkaj: Jo, nuk i kemi kërkuar.

Z. I. Rusmali: Jo, atë ne e kemi diskutuar dhe aty gjërat janë të qarta, por, lidhur me vendimin tjetër, subjekti kërkon pushimin e hetimit administrativ për të gjitha objektet ku thuhet se janë më afër se 300 metra. Ka një lapsus aty, “jo më afër”, janë më afër se 300 metra nga KQV-të apo KZQV-të. Me çfarë argumenti e kërkon ju pushimin e të gjitha këtyre, përveç Bashkisë së Kukësit?

Z. F. Nuri: Atëherë, kemi marrë pak a shumë të gjitha rastet ku, në vlerësimin tonë, ato kanë qenë më përpara dhe më pas është ndryshuar qendra e votimit, në informacionet që ne na kanë ardhur, dhe kjo ka bërë që distancat të afrohej.

Z. I. Rusmali: Dakord, por fakti është që distancat janë afruar, “Artan Lenja” 150 metra, “Milto Tutulani” 58 metra, “Margarita Tutulani” 110 metra, 50 metra në Elbasan.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt.11.05.2023

Z. K. Bele: Unë shoh që shkolla “Dëshmorët e Lirisë”, nëse unë nuk e ngatërroj mot e jetë ka qenë qendër votimi. Dhe në përgjithësi shkollat kanë qenë gjithmonë qendra votimi dhe pa dashur të vë në diskutim atë se ju në fund të ditës flisni me informacionet që keni, jeni në të drejtën tuaj si mbrojtës ligjor, por është fakt që qendrat e votimit nëpër shkolla ka hyrë në një pozicion sa qendra dhe dyshoj që ndonjë shkollë, mbase është ndonjë shkollë e re që është përruruar këto ditë, pra janë qendrat ekzistuese.

(Diskutime pa mikrofon)

Z. I. Rusmali: Ndiz mikrofonin!

Z. Y. Merkaj: Shkollat e reja janë qendra votimi.

Z. K. Bele: Pra, të gjitha shkollat janë qendra votimi.

Z. Y. Merkaj: Po, të gjitha shkollat.

Z. L. Braho: Këto tri pikat e tjera, Ylli, që janë dy shtylla ndriçimi në Tiranë, pastaj shtyllë ndriçimi po prapë në Tiranë në rrugën “Veli Dedi”, në Bashkinë Durrës fasadën e qendrës tregtare *Flag Ship*. Për këto është e njëjta bazë ligjore?

Z. Y. Merkaj: Po, është pika 2 që citova edhe në fasadat e godinave dhe në shtylla.

Z. L. Braho: Pra, e njëjta bazë ligjore, udhëzimi.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.05.2023*

Z. E. Çefa: Unë kam një pyetje për administratën për mënyrën e matjeve, e konstatimit të distancave, si i matni këto? 58 metra për shembull, si i matni? Dërgoni një njeri me metër t'i matë, apo i matni nga *google maps*?

Z. Y. Merkaç: Është monitoruesi ai që bën matjet. Monitoruesi mbase edhe me *google maps*, edhe me metër mund ta matë, por distancat janë. Nuk kemi parë ndodnjë ankim ose vendim Komisioneri që të kundërshtohet matja e largësisë. Na kanë thënë që i kanë rezultuar që janë matur saktësisht nga monitoruesit.

Z. L. Braho: I referohem gjithmonë distancës, sepse edhe banoj në atë zonë, nga Liceu Artistik tek selia e degës 2 të partisë që kundërshtojnë këta. Mua më duket shumë larg kur kaloj atje për arsytet e mia të jetesës të dalë xhiro në atë lagje, të blej diçka mua më duket shumë larg, dhe nuk janë as në të njëjtën rrugë. Doja të dija mos mbase maten më *google maps* në vijë ajrore vëzhguesi juaj dhe mbase në rrugë tokësore e kalon distancën? Këtë doja të dija.

Z. Y. Merkaç: Monitoruesi ka raportuar që janë 180 metra. Gjatë hetimit administrativ nuk është ngritur pretendimi që është më shumë se 180 metra, ose më shumë. Për sa kohë që është kundërshtuar është marrë i mirëqenë raportimi monitoruesit.

Z. F. Nuri: Ndoshta është matur me hapa. Pyetja ime, për ta kuptuar se si matet kjo distancë, ose dhe për ta ditur është: a e ka barrën e provës administrata për ta provuar që është në vendimi me ligjshmërinë apo e ka kërkuesi? Flas për distancën.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.05.2023*

Z. Y. Merkaj: Mendoj se distanca dhe monitoruesit e matin me metër, natën apo ditën, nuk e di, por e matin me metër.

Z. E. Çefa: Jo edhe një konstatim tjetër kam unë se me dendësinë për dendësinë e banorëve për kilometër katror që ka Tirana unë besoj se është praktikisht e pamundur të ruajmë këto distanca. Unë besoj se nuk mundët dot që të jetë të paktën 300 metra larg, sepse kalon te lagjja tjetër, pra më duket pak si e paarsyeshme si koncept. Ka shumë pikëpyetje kjo çështje.

Z. F. Nuri: Përfundimisht ne kërkojmë pranimin e kërkesës. Faleminderit!

Z. Y. Merkaj: Ne kërkojmë rrëzimin e kërkesës si të paarsyetuar dhe argumentuar dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit numër 452, dhe 456.

Z. K. Bele. Faleminderit! KAS, tërhiqet për vendim dhe ju njoftojmë për një ekonomik nëse do të arrijmë për një vendimmarrje të shpejtë.

Rifillon seanca

Ora 15:40

Z. K. Bele: KAS-i, në përfundim të shqyrtimit administrativ vendosi: “Rrëzimin e ankimit për pikën 1 të vendimit, kundërshtimin e vendimit të Komisionerit numër 452, datë 06.05.2023 “Për vlerësimin e raporteve monitoruese të fushatës zgjedhore për periudhën e monitorimit 7 mars-2 maj 2023 për vendimin e Komisionerit numër 456 për shqyrtimin administrativ të denoncimit 387 nga PS-ja për heqjen e

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.05.2023*

materialeve zgjedhore të vendosura në kundërshtim me ligjin nga koalicioni “Bashkë Fitojmë”; rrëzimin e ankimit të KSHZ numër 452 datë 06.05.2023 për pikën “a” pushimin e hetimit administrativ në lidhje me kërkesat për mbylljen e zyrave zgjedhore të subjektit të koalicionit “Bashkë Fitojmë” në bashkinë Tiranë me vendndodhje rruga “Artan Lenja”, “Milto Tutulani” dhe “Margarita Tutulani”; në Bashkinë Elbasan me vendndodhje pranë universitetit “Aleksandër Xhuvani”; pranimin e pjesëshëm të pikës 3/b të ankimit duke shfuqizuar vendimin e Komisionerit për këtë pikë të vendimit për hetimin administrativ në lidhje me kërkesën për mbylljen e zyrës së Partisë Demokratike në rrugën “Nasip Pavllo” pranë Liceut Artistik për arsyet e thënë në vendimi, rrëzimin e kërkesës për pushimin hetimit administrativ në lidhje me kërkesën për heqjen e materialeve propagandistike në Bashkinë Durrës Tiranë në lidhje me subjektin Bashkë Fitojmë në shtylla ndriçimi në rrugën “Veli Dedi”, dhe rrëzimin e kërkesës për ndryshimin e vendimit të KSHZA-së numër 456 datë 06.05. 2023, duke vendosur pushimin e hetimit administrativ në lidhje me heqjen e menjëhershme të materialit propagandistik mbi fasadën e Postës Shqiptare në Kavajë të koalicionit “Bashkë Fitojmë”. Kundër këtij vendimi bëhet ankim në Kolegj Zgjedhor brenda afatit 5 ditor”. Ky vendim hyn në fuqi e menjëherë. Me kaq seancën e deklaroj të mbyllur.

Vendimi nr. 93

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për shqyrtimin në themel të kërkesës ankimore nr. 56.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, E. Mema.
- **Parti Politike:** PS (M. Legisi)
- **Të tjerë:**

Z. K. Bele: Përshëndetje, çelim seancën për shqyrtimin në themel për kërkesën ankimore numër 56, e cila lidhet me ankimin kundër vendimit për shqyrtimin administrativ të denoncimit numër 392, nga Koalicioni Bashke Fitojmë, për afishimin e materialeve propagandistike, në kundërshtim me ligjin, nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste, në aksin kombëtar rruga “Elbasan-Librazhd” për zgjedhjet nga organet e Qeverisjes Vendore. Pra për vendimin e Komisionerit numër 472, datë 09.05.2023 me objektin që lexova më lartë. Të pranishëm KAS me katër anëtarët e tij, administrata e KQZ-së përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm. Palë të tjera të interesuara?

Z. M. Legisi: Po, avokat Mariglen Legisi me autorizim të posaçëm për këtë kërkesë, faleminderit.

**Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.05.2023*

Z. K. Bele: Në këtë fazë kërkime paraprake apo deklarime? Nuk kemi, atëherë vazhdojmë me shqyrtimin e themelit, duke i kërkuar ankuesit të prezantojë shkurt. Çfarë kërkon?

Z. M. Legisi: Po faleminderit të nderuar , ankimi jonë lidhet me vendimin numër 472, datë 09.05.2023, të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, në lidhje me shqyrtimin administrativ, denoncimi numër 392, të Koalicionit Bashkë Fitojmë për afishimin e materialeve propagandistike. Rasti konkret sipas denoncuesit edhe më tej të Komisionerit lidhet me një poster në rrugën nacionale Elbasan-Librazhd ku sipas faktit të konstatuar dhe të pretenduar mungon mbishkrimi, nuk përmban shënimin prodhuar në përgjegjësin ligjore të subjektit zgjedhor. Në vlersimin tonë bazuar në provat e depozituara bashkëlidhur këtij ankimi, rezulton e provuar që posteri e ka përmbajtur shënimin që pretendohet se mungon por është i vogël realisht duke u nisur edhe nga hapsirat që krijon ligji , pra është i vogël dhe krijon ndoshta edhe pengesa për denoncuesin për ta konstatuar si të tillë dhe e konsideron si mbishkrim të munguar. Ne vlersojmë që ankimi duhet pranuar pasi nuk është i bazuar në baza, në fakte, faleminderit.

Z. K. Bele: Zoti Merkaj!

Z. Y. Merkaj: Atëherë, në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve është administruar denoncimi me numër 392, datë 06.05.2023, nga Koalicioni Bashkë Fitojmë , ku pretendohet se në rrugën nacionale Elbasan- Librazhd, pranë restorantë Ballës, Labinot-Fushë në një tabelë është konstatuar afishimi i materialit propagandistik, në përmasa të përafërta 10 metra me 3 metra, në kundërshtim me ligjin dhe udhëzimet

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.05.2023*

e nxjerra prej tij, nga subjekti zgjedhor Parta Socialiste e Shqipërisë. Komisioneri ka vlersuar se duhet të futet në shqyrtim administrativ pasi ka elementët për të shqyrtuar dhe me vendimin 4472, datë 09.05.2023, ka marrë në shqyrtim këtë vendim administrativ dhe gjatë hetimit administrativ. Komisioneri ka lënë porosi monitoruesit, të emëruar nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve të bëjë verifikimin e kësaj tabele dhe në raportin e sjellë nga monitoruesi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është shprehur që nuk e përmban shënimin prodhuar në përgjegjësin ligjore të subjektit. Në këto kushte Komisioneri ka vendosur urdhërimin e policisë së shtetit dhe policisë bashkiake për heqjen e menjëherëshme të materialit propagandistik të subjektit zgjedhor Partia Socialiste në rrugën Elbasan-Librazhd pranë restorant ballës, Labinot-Fushë.

Z. K. Bele: Mirë, ne kemi një paqartësi që lidhet me faktin që nga ankuesi është vënë në dispozicion një fotografi, që e ka atë shënimin e vogël siç e arsyetoi ankuesi, e cila tregon një tabelë, se në ndryshim nga rasti i mëparshëm i ngjashëm që ne vlersuam, ku bëhej fjalë për një aks, këtu flitet për një tabelë. Tani tabela që kanë sjellë, tabela që keni ju këtu është e ndryshme nga ajo që ka sjellë ankuesi dhe nuk e dimë kush është e sakta që të jemi të sigurtë, sepse kjo e sjella nga ankuesi tregon që është mbi një tarracë lokale, pastaj a është restorant me atë emër apo ndonjë restorant tjetër këtë nuk e dimë, kurse kjo këtu është anës rrugës dhe nuk duket restoranti i pretenduar, pra materiali denoncues i shfrytëzuar nga ju. Mund të na saktësoni cila nga këto është? Pra ku është posterit?

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.05.2023*

Z. Y. Merkaç: Komisioneri gjatë hetimit administrativ, ka marrë në shqyrtim posterin e parë që është dorzuar nga administrata dhe monitoruesi ka bërë verifikim për këtë poster, jo posterin që ka sjellë ankuesi.

Z. K. Bele: Unë jam i bindur që edhe ne vetë po ta shikojmë në google do e gjejmë. Jo, të gjejmë ku është restoranti, cfarë pamje ka.

Si në seancën e kaluar ne konstatojmë që ka paftueshmëri në administrimin e fotove, në vlersimin tonë me këtë shkallë dixhitalizimi, ku arrihet të bëhet foto e çdo vote, në 100 KZAZ dhe pse është pamundësia që ne të bëjmë një foto të qartë që të kemi një dokument, sepse minimumi ne duhet të ballafaqojmë provën që na sjellë pala ankuese rast pas rasti, meqë u bë rasti i dytë, po mund të kemi të tjera, me atë mbi të cilën është gjykuar vendimarrja në hetimin administrativ. Edhe kjo foto këtu mikroskopike nuk të bind, nuk po themi që është marrë nga... po kjo nuk të bind.

Z. Y. Merkaç: Komisioneri është bazuar më shumë tek raporti, raporti i mbishkrimit të monitoruesit.

Z. K. Bele: Për sa kohë ajo shoqërohet me një foto do të duhet që ajo të ishte e mjaftueshme për tu shqyrtuar që ne të krijojmë dyshimin e arsyeshëm, megjithatë pa paragjykuar vendimarrjen, ne kemi një vendim të ngjashëm për një situat duke u referuar drejt e drejt ligjit. Ka ndonjë pyetje nga kolegët?

Z. I. Rusmali: Di njëri të na thotë çfarë ka ndodhur me këtë poster me këtë tabelë?

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.05.2023*

Z. Y. Merkaj: Tani kam marrë një përgjigje nga policia bashkiake dhe policia e shtetit Elbasanit, që thonë tek raportimi që ka bërë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, thonë që e kemi hequr si poster por nuk e dimë është hequr apo jo. E kemi përgjigjen këtu mund t'ju a vëmë në dispozicion.

Z. I. Rusmali: Më fal, meqënëse jemi tek Ylli, ju thatë që i keni dërguar letër policisë për heqjen e materialit në raport, duke saktësuar vetëm për rastet. Apo është vetëm për aksin Tiranë-Lushnjë? Se në seancën e mëparëshme, u tha që i është dërguar shkresë policisë duke i thënë që të hiqen ato postera që nuk kanë shënim.


Z. Y. Merkaj: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve duke patur problematik të shtuar tek kjo ka marrë dhe një vendim tjetër përgjithësues, vendimi 424, ku ja ka përcjell të gjitha bashkive, tek të gjitha bashkitë që të heqin të gjitha materialet propagandistike që ju mungon shënim, për të prodhuar në përgjegjësin ligjore të subjektit. Përveç këtij vendimi që janë individuale ka marrë dhe një vendim përgjithësues dhe jua a ka çuar të gjitha bashkive të vendit, të 61 bashkive, në datën 04.05.2023, vendimi 424. Me posterin nuk di ta them unë di që përgjigjia e policisë bashkiake të Elbasanit thotë që i kanë hequr posterat.

Z. I. Rusmali: E konfirmuar kjo apo se dini?

Z. M. Legisi: Jo, ne nuk kemi informacion në lidhje me këtë pjesë i nderuar

Z. K. Bele: Një pushim sa të sqarohet kjo.

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.05.2023*

Mirë e çelim seancën. Nga ana e administratës? Riçelim shqyrtimin administrativ të kërkesës ankimore numër 56, u njohëm gjatë kësaj kohe nga ana e administratës së KQZ-së, u depozitua si provë shkresa e dërguar nga ana e policisë bashkiake ose Bashkisë Elbasan me numër 28/74 datë 11.05.2023, e cila krahas të tjerash shpjegon se është hequr materiali propagandistik i vendosur në rrugën nacionale Librazhd-Elbasan, duke cituar dhe vendimin e objekt ankimi me numër 472. Në këto kushte konstatojmë që objekti ose posterit i objektit të këtij shqyrtimi nuk është, ose është hequr nga vendi ku është vendosur. Para se të shkijmë, pyetje të tjera nuk besoj se kemi. Ka ndonjë qëndrim nga ana juaj në përfundim të kësaj?

Z. M. Legisi: Po faleminderit, i nderuar në këto kushte, rrethana fare të konfirmuara në këtë seancë, ne e vlersojmë që jemi përpara rastit të marrjes së një vendimi pushimi, në bazë të nenit 45, pika 1, gërma "A" e vendimit numër 3, të 2020 për mënyrën e funksionimit të zhvillimit të sencave pranë KAS-it, faleminderit.

Z. Y. Merkaj: Deklarojmë pushim ne.

Z. K. Bele: Atëherë KAS i konsultuar në vend, vendos: pushimin e shqyrtimit administrativ për kërkesën ankimore numër 56. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. Kundër vendimit bëhet ankim brenda 5 ditëve në Kolegjin Zgjedhor. Me kaq seanca deklarohet e mbyllur, faleminderit.

Vendimi nr. 94

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.05.2023*

Data: 11.05.2023

Ora: 16:13

RENDI I DITËS

“Për pranimin për shqyrtim të kërkesës nr . 25 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për vendosje sanksioni”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema,
- **Parti politike:**
- **Të tjerë:**

Z. L. Braho: Përshëndetje! Çelim seancën e shqyrtimit paraprak të kërkesës nr. 25 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, të datës 10.05.2023. Nëpërmjet kësaj kërkesë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i kërkon KAS-it vendosjen e sanksioneve administrative ndaj zotit Gledjan Llatja, kryetar i Bashkisë së Elbasanit, zotit Andi Salla kryetar i Bashkisë së Cërrikut, zotit Rakip Suli, kryetar i Bashkisë së Kamzës. Për secilin prej tyre kërkohet vendosja e sanksionit administrativ në masën dhjetë mijë lekë të reja. Atëherë, në lidhje me praninë e palëve të interesuara, nuk janë të pranishëm asnjë prej tyre ose përfaqësues të tyre. Kemi të pranishëm përfaqësuesin e KQZ –së, sekretarin e Përgjithshëm. Fjala për

1

**Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA**



***Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.05.2023***

sekretarin e Përgjithshëm, në lidhje me elementet e formës dhe përmbajtjes për sa i përket kësaj kërkesë të Komisionerit.

Z. Y. Merkaj: Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë regjistruar indicie për organizimin e 8 veprimtarive publike nga 5 institucione publike, për të cilat pretendohet se janë bërë në kundërshtim me nenet 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë në shqyrtim administrativ rastet objekt denoncimi dhe ka konstatuar se përbëjnë shkelje të neneve 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor. Në këto kushte i është drejtuar KAS-it me kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj kryetarit të Bashkisë së Elbasanit në masën dhjetë mijë lekë, ndaj kryetarit të Bashkisë së Cërrikut masën dhjetë mijë lekë dhe ndaj kryetarit të Bashkisë së Kamzës në masën dhjetë mijë lekë. Nga konstatimi dhe verifikimi paraprak i kërkesës konstatohet se është në përputhje me elementet formale të nenit 130 të Kodit Zgjedhor. Kështu që kërkohet të kalojë për shqyrtim kërkesa. Faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit! Atëherë KAS-i konsultuar në vend vendos kalimin për shqyrtim administrativ të kërkesës nr. 25, datë 10.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Seanca për shqyrtimin administrativ të kësaj kërkesë ankimore do të bëhet nesër, në datën 12 maj në orën 13:00. Seancën e deklaroj të mbyllur.

Vendimi nr. 95

***Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA***

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt :11.05.2023*

Data: 11.05.2023

Ora: 16:20

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për pranimin për shqyrtimin e kërkesës ankimore me nr . 24 të KSHZ-së.”

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema,
- **Parti politike:**
- **Të tjerë:**

Z. I. Rusmali: Atëherë çelim seancën për shqyrtimin e kërkesës së Komisionerit nr. 24, datë 10.05.2023 me të cilën Komisioneri vë në lëvizje KAS-in për marrjen e masës administrative ndaj zotit Florenc Doka, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë e Cërrikut dhe ndaj zotit Astrit Sefer Kolli, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë e Devollit. Në seancë merr pjesë sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, zoti Merkaj dhe ekipi i tij, ndërkohë që nuk janë të pranishëm personat e interesuar ndaj vendimmarrjes së

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt :11.05.2023*

KAS-it, zoti Florenc Doka dhe zoti Astrit Sefer Kolli ose përfaqësuesit e tyre, ndonëse janë njoftuar rregullisht. KQZ-ja e konfirmon që janë njoftuar rregullisht për zhvillimin e kësaj seance. Nga Komisioni nuk ka ndonjë pretendim ndonjë kërkesë për konflikt interesi, deklaram, kështu që mund të vazhdojmë me shqyrtimin paraprak, me elementet e formës dhe përmbajtjes, duke ia dhënë fjalën zotit Merkaj, që të na bëjë këtë analizë.

Z. Y. Merkaj: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë indicie për organizim e shtatë veprimtarive publike nga 6 institucione, për të cilat pretendohet se nuk janë raportuar në ndërfaqen e dedikuar për këtë qëllim. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, duke parë se të dhënat krijojnë bazë mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ, ka çelur hetimin administrativ dhe ka marrë vendim për shqyrtimin e këtij denoncimi dhe në përfundim të hetimit administrativ, duke qenë se rasti objektit denoncimi, ndaj personit përgjegjës të Bashkisë së Cërrikut dhe Bashkisë së Devollit përbëjnë shkelje të pikës 1 të nenit 92 dhe pikës 4 dhe 3 të vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator, i ka propozuar Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve marrjen e masave administrative ndaj personit përgjegjës për raportimet të veprimtarive publike në Bashkinë e Cërrikut në masën 5 mijë lekë dhe personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë e Devollit në masën 5 mijë lekë. Nga shqyrtimi paraprak i kërkesës konstatohet se i plotëson të tria elementet e formës dhe të përmbajtjes parashikuar nga neni 130 i Kodit Zgjedhor.

2

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt :11.05.2023*

Z. I. Rusmali: Faleminderit, zoti Merkaj! Ka ndonjë gjë nga kolegët? Jo. KAS-i i konsultuar në vend konstaton, gjithashtu, që kërkesa i plotëson të gjitha parametrat e përcaktuar nga aktet që menaxhojnë punën, veprimtarinë tonë për shqyrtimin e këtyre kërkesave, kështu që vendos kalimin për shqyrtimin e kërkesës. Seanca e shqyrtimit është nesër në orën 13:30. I kërkoj administratës që të njoftojë, përveç 2 personave për të cilën kërkohet marrja e masës administrative, edhe personat e tjerë që kanë qenë në hetim, sepse eventualisht mund të vendoset për ndonjërin që të kalohet në masë administrative. Janë në vendimin e Komisionerit. Mirë, e mbyllim këtu këtë seancë të shqyrtimit paraprak.

Vendimi nr. 97

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.05.2023*

11.05.2023

Ora, 16:23

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për pranimin për shqyrtimin e kërkesës ankimore me nr. 26 të KSHZ-së”


PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema,
- **Parti politike:**
- **Të tjerë:**

Z. E. Çefa: Mirdita! Çelim seancën për vlerësimin e elementeve të formës dhe të përmbajtjes të kërkesës të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me nr. 26 të datës 10 maj 2023, me objekt kërkesën për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zotit Arben Qafa, drejtor i Qendrës Kulturore Margarita Tutulani në Berat, në vlerën e 5 mijë lekëve. Sipas shortit të hedhur në ditën e djeshme në KQZ, relatori i kësaj çështje jam caktuar unë, Elvis Çefa. Verifikoj fillimisht pjesëmarrjen. Është prezent trupa e KAS-it, është prezent sekretari i Përgjithshëm i KQZ –së, i cili në këtë procedim do të përfaqësojë Komisionerin. Nuk ka prezencë të palëve të interesuara, megjithëse rezulton që të kenë marrë dijeni, të jenë njoftuar rregullisht nga administrata e KQZ –së. Sipas procedurës, ia jap shkurtimisht fjalën sekretarit

1

*Zbardhi materialin audio
Eneta STEFA*



***Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.05.2023***

të Përgjithshëm, për relatimin e elementeve të formës dhe të përmbajtjes të kësaj kërkesë. Zoti Merkaj.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë indicie për organizmin e 8 veprimtarive publike nga 5 institucione publike, për të cilat pretendohet se janë kryer në kundërshtim me përcaktimin e neneve 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9 të vitit 2020 të Komisionit Rregullator. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, duke vlerësuar se informacionet dhe të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ, ka çelur këtë hetim dhe ka marrë në shqyrtim këto denoncime. Në përfundim të shqyrtimit administrativ ka vlerësuar se rastet objekt denoncimi përbëjnë shkelje të neneve 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor, ka vendosur t'i propozojë KAS-it marrjen e masave administrative: vendosje gjobe në masën 10 mijë lekë për kryetarin e Bashkisë së Elbasanit, kryetarin e Bashkisë së Cërrikut dhe kryetarin e Bashkisë së Kamzës. Nga verifikimi paraprak i kërkesës konstatohet se...

Z. E. Çefa: Jemi tek...

Z. Y. Merkaj: Kërkesa ankimore nr. 25.

Z. E. Çefa: Jo. nr. 26 që është për zotin Arben Qafa. Propozuar gjobë 5 mijë lekë. Është vetëm ky që propozohet.

Z. Y. Merkaj: Personi përgjegjës, drejtori i Qendrës Kulturore Margarita Tutulani në Berat, në vlerën 5 mijë lekë, është kapur, është konstatuar dhe vlerësuar se ka

***Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA***

***Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.11.05.2023***

shkelur nenet 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor dhe vendimin me nr. 9 të Komisionit Rregullator. Në këto kushte Komisioneri i propozon KAS-it marrjen e masës administrative ndaj drejtorit të Qendrës Kulturore Margarita Tutulani në Berat, në vlerën 5 mijë lekë. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Atëherë, duke qenë se kjo kërkesë e Komisionerit i plotëson elementet formale, KAS-i i konsultuar në vend vendosi kalimin për shqyrtimin në seancë, e cila do të zhvillohet nesër në orën 14:00. Pra, nesër në datën 12 maj 2023, në orën 14:00. Me kaq seancën e deklaroj të mbyllur. Faleminderit!

Vendimi nr. 98

***Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.05.2023*

11.05.2023

Ora, 16:27

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për pranimin për shqyrtimin e kërkesës ankimore me nr . 57”

PJESËMARRJA:


- **KAS-i:** **Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele.**
- **Stafi i KQZ-së:** **Z. Ylli Merkaç.**

Z. K. Bele: Çelim seancën e verifikimit paraprak të kritereve të formale lidhur me kërkesën ankimore nr. 57. Subjekti ankues Ledjan Llatja, kryetar i Bashkisë së Elbasanit, ndaj vendimit nr. 441 të datës 05.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Që në fillim prezent është trupa e KAS-it, si dhe sekretari i Përgjithshëm. Relatojmë se pranë KAS-it bashkë me kërkesën, është depozituar një heqje dorë e ankimit me datë 11.05.2023, me nr. shkrese 49/91, ku ankuesi kërkon të heqë dorë nga ankimi tij ndaj vendimit nr. 441 të Komisionerit, pasi kjo është një çështje që, në fakt, nuk ka të bëjë me KAS-in, sepse është ankuar ndaj propozimit të Komisionerit për vendosjen e sanksionit administrativ. Pra, ka një keqkuptim të ankuesit, mendojmë ne, pavarësisht se nuk i ka specifikuar shkaqet e

1

Zbardhi materialin audio

Eneida STEFA



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.05.2023*

tij në kërkesën për dorëheqje. Në këto kushte, mendoj që KAS-i, i konsultuar në vend, vendos pushimin e shqyrtimit dhe me kaq seancën e deklaroj të mbyllur.

Vendimi nr. 99

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.05.2023*

11.05.2023

Ora:16:28

RENDI I DITËS

*“Për pranimin për shqyrtimin e kërkesës ankimore me nr. 58 nga subjekti
ankimues, zoti Safet Gjici, kryetar i Bashkisë së Kukësit”*

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema,
- **Parti politike:**
- **Të tjerë:**

Z. I. Rusmali: Çelim seancën e shqyrtimit paraprak për kërkesën ankimore nr. 58 të depozituar nga ankuesi Safet Gjici, kryetar dhe kandidat për kryetar i bashkisë për subjektin Partia Socialiste për Bashkinë e Kukësit. Ankimi është kundër vendimit nr. 439 datë 05.06.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Nuk ka prezencë të përfaqësuesit të tij, është prezent trupa e KAS-it, administrata e KQZ – se nën drejtimin e Ylli Merkaj, sekretar i Përgjithshëm. Zoti Merkaj.

Z. Y. Merkaj: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore nr. 58, me ankimues Safet Gjicin, i cili kundërshton vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 439 datë 5 maj 2023. Ky vendim është

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

***Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 11.05.2023***

ankimuar dhe më parë dhe kjo i është drejtuar KAS-it dhe KAS-i ka marrë vendim për këtë. Komisioneri është shprehur një herë, kështu që mendojmë që ankimesi nuk legjitimohet në ngritjen e kësaj kërkesë dhe mendojmë që të pushohet gjykimi; kërkohet nga KAS-i.

Z. I. Rusmali: Mirë, kolegët nuk kanë gjë. Atëherë, KAS-i vendosi përfundimisht në shqyrtim të kësaj kërkesë, mospranimin e saj për mungesë të legjitimitetit, sepse, siç është deklaruar edhe më parë nga ana e KAS-it, këto lloj vendimesh nuk ankimohen sa kohë që KAS-i investohet. Me kërkesë për vendosjen e sanksionit në përputhje me kompetencën e vet, ankimesit i lind e drejta të ankohet ndaj vendimit të KAS-it, i cili është marrë ndërkohë dhe afati i ankimit për të ka filluar. Me kaq e mbyllim edhe shqyrtimin paraprak të kësaj kërkesë.

Vendimi nr. 100

***Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA***

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt :11.05.2023*

11.05.2023

Ora 17:16

RENDI I DITËS

“Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore me nr. 59 nga subjekti ankimues zoti Safet Gjici, kryetar i Bashkisë së Kukësit”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Elvis Çefa, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema,
Z. K. Puleri.
- **Parti politike:** PS
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. L. Braho: Çelim seancën për shqyrtimin e elementeve të formës dhe të përmbajtjes kërkesës ankimore nr. 59, të depozituar në KQZ në datën 11.05.2023, me subjekt ankimues zotin Safet Gjici, në cilësinë e kryetarit të Bashkisë së Kukësit, njëkohësisht edhe kandidat për kryetar bashkie, po në Bashkinë e Kukësit për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Kërkesa ankimore ka për objekt vendimin nr. 440 datë 05.06.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. I pranishëm është vetëm sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, që përfaqëson këtu KQZ-në. Zoti Merkaj, në lidhje me elementet e formës dhe të përmbajtjes të kësaj kërkesë ankimore.

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt :11.05.2023*

Z. Y. Merkaj: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa ankimore nr. 59, me ankimues Safet Gjici, që kundërshton vendimin nr. 440 datë 05.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Nga verifikimi paraprak i elementeve formale të kërkesës konstatohet se kërkesa i ishte drejtuar Komisionit të Ankimimit dhe Sanksioneve. Në fakt, ky komision ka shqyrtuar vendimin nr. 440 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Në këto kushte, kërkuesi nuk legjitimohet në ngritjen e kësaj kërkesë. I mungojnë të dyja elementet: kompetenca dhe legjitimimi.

Z. L. Braho: Atëherë, KAS-i i konsultuar në vend, vendosi moskalimin për shqyrtim të kësaj kërkesë ankimore, me argumentin se kërkuesi nuk ka legjitimitet. Po ashtu edhe KAS-i nuk ka kompetencë për shqyrtimin e kësaj kërkesë. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ndaj këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative dhe Apelit brenda 5 ditëve nga hyrja e këtij në fuqi. Seancën e deklaroj të mbyllur.

Vendimi nr. 96

*Zbardhi materialin audio
Enëida STEFA*